VENDIM
Nr. 45, datë 25.7.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 27.5.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Deklarimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 14/2014 datë 20.2.2014 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BAZA LIGJORE: Nenet 94, 131, shkronja “ç” dhe 134/1, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 14/3 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 12/2014 datë 20.2.2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka vendosur “Shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr. 1/2013 të Kuvendit, për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe lirimin nga detyra të Inspektores të Përgjithshme të ILDKPKI-së, znj. Zana Xhuka. Me vendimin nr. 14/2014 të datës 20.2.2014, Kuvendi ka vendosur zgjedhjen në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave z. Shkëlqim Ganaj.

II

2. ***Kërkuesi, Presidenti i Republikës së Shqipërisë***, pretendon që vendimi i Kuvendit ka krijuar një konflikt me kompetencat e Presidentit të Republikës, duke parashtruar sa më poshtë:

2.1 Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit; Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 14/2014, datë 20.2.2014, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjen e z. Shkëlqim Ganaj në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

2.2 Në çështjen objekt kërkese është krijuar një konflikt kompetencash me natyrë normative midis dy organeve kushtetuese, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

2.3 Mohimi nga Kuvendi i së drejtës së Presidentit që me rastin e krijimit të vakancës në ILDKPKI, lidhur me postin e Inspektorit të Përgjithshëm të propozojë kandidaturat për këtë post, ka krijuar një konflikt, i cili legjitimon kërkuesin t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për zgjidhje.

2.4 Sipas pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003, Kuvendit të Shqipërisë i lindte detyrimi që lidhur

me vakancën e krijuar nga lirimi nga detyra e znj. Zana Xhuka, të njoftonte Presidentin e Republikës, me qëllim që ky i fundit të ushtronte të drejtën e tij për të propozuar brenda 15 ditëve dy kandidatura për Inspektor të Përgjithshëm.

2.5 Objekti i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetuese të ndarjes së pushteteve, pasi balancimi mes pushteteve ka ndryshuar.

2.6 Fakti që z. Ganaj ka qenë një nga kandidaturat që së bashku me znj. Xhuka janë propozuar në Janar të vitit 2013 nga Presidenti i Republikës për detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm nuk e legjitimon Kuvendin, të zgjedhë në këtë detyrë kandidaturën tjetër, atë të zotit Ganaj, tashmë të rrëzuar nga ai Kuvend. Një akt i cili i solli pasojat për të cilat është krijuar nuk mund të revokohet për të prodhuar të njëjtat pasoja.

3. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,*** në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si më poshtë:

3.1 Kuvendi i Shqipërisë kërkon rrëzimin e kërkesës së Presidentit të Republikës, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis tij dhe Kuvendit dhe deklarimin e papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 14/2014, datë 20.2.2014, të Kuvendit, "Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI".

3.2 Çështja objekt shqyrtimi mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, del nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese.

3.3 Një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta, si dhe "kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë prej saj".

3.4 Nga të tri kushtet që kërkon jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, për të pasur (dhe për të zgjidhur më pas) një mosmarrëveshje kompetence, për rastin në shqyrtim, plotësohen vetëm dy prej tyre dhe se nuk plotësohet kushti i tretë, që lidhet me kompetencën kushtetuese.

3.5 Kompetenca, të cilën Presidenti i Republikës pretendon se është cenuar dhe për të cilën ka iniciuar këtë gjykim, nuk është kompetencë kushtetuese, sepse në asnjë normë të Kushtetutës nuk parashikohet, as shprehimisht, por as në mënyrë të nënkuptuar, kompetenca e Presidentit për propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

3.6 Referuar ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",* padia për shpalljen e paligjshmërisë së vendimit të Kuvendit, për mënyrën e shkarkimit dhe të zgjedhjes së kreut të ILDKPKI-së, është në juridiksionin e gjykatave administrative.

3.7 Formulimi i përdorur nga Kushtetuta në nenin 94 është me karakter mohues. Pra, Presidenti i Republikës ndalohet (është në mënyrë mohuese), të ushtrojë funksione tej atyre që nuk i njihen shprehimisht me Kushtetutë.

3.8 Kuvendi, nëpërmjet vendimmarrjes së kryer gjatë seancës së datës 20.2.2014, jo vetëm ka synuar rregullimin e situatës së kundërligjshmërisë flagrante të shkaktuar prej veprimtarisë së tij në ushtrim të funksionit të zgjedhjes së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, por edhe ka dashur dhe synuar të respektojë në mënyrë të plotë e të pacenuar kompetencën dhe të drejtën ligjore të Presidentit për propozimin e kandidaturave për këtë funksion, kompetencë dhe e drejtë kjo që lind në rastin dhe çastin e krijimit të vakancës.

3.9 Në vlerësimin e Kuvendit, rikthimi te situata përpara votimit të dekretit presidencial nr. 7928, datë 16.1.2013, si pasojë e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimmarrjes së tij, çonte në domosdoshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe votimit plotësisht prej Kuvendit të këtij dekreti, akt i cili nuk mund të konsiderohej prej tij krejt si i paqenë, inekzistent.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

4. Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuesit, të parashtruara në kërkesë dhe në parashtrimet përfundimtare konsistojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit, e cila, sipas kërkuesit, ka ardhur si pasojë e nxjerrjes së vendimit nr. 14/2014 të datës 20.02.2014, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjykata, pas marrjes në shqyrtim të pretendimeve të kërkuesit dhe të prapësimeve të subjektit të interesuar, ia nënshtroi ato procesit të votimit, por nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj[1], për pranimin ose

[1] Katër gjyqtarë votuan për mosshqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuesit, nga të cilët gjyqtarët: Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha, votuan për pushimin e gjykimit dhe gjyqtari Sokol Berberi votoi për mungesë

rrëzimin e kërkesës, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 133/2 të Kushtetutës dhe në nenin 72/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

5. Në kushtet kur, gjatë votimit të çështjes, votat u ndanë në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk arriti të votohej nga shumica e kërkuar, Gjykata, vlerëson se kërkesa duhet refuzuar. Në referim të nenit 74 të ligjit organik, refuzimi i kërkesës për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm të votave, nuk përbën pengesë që kërkuesi të riparaqesë kërkesën, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", nenit 134, pika 1, shkronja "g", nenit 133/2 të Kushtetutës; neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

MENDIM

Në lidhje me çështjen me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

1. Në çështjen me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e pretenduar si e krijuar nga vendimi nr. 14, datë 20.2.2014 "Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave", i Kuvendit është vendosur refuzimi i kërkesës për shkak se nuk u arrit të votohej me shumicën e kërkuar nga Kushtetuta dhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese. Për arsye se mendoj se kjo çështje duhet të ishte shqyrtuar në themel, vlerësoj të shprehem me mendim pakice.

2. Gjykata ka pasur në vazhdimësi një jurisprudencë të konsiderueshme në drejtim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe për pasojë edhe në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencës mes pushteteve, e vënë në lëvizje nga subjektet e përcaktuara në Kushtetutë, përfshirë dhe çështje me kërkues Presidentin e Republikës. (*shih vendimin nr. 41, datë 19.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se në kërkesat me objekt mosmarrëveshjet e kompetencës, duhet që së pari, organet t'i përkasin pushteteve të ndryshme; së dyti organet të kenë deklaruar vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin; si dhe konflikti të ketë natyrë kushtetuese, pra që kompetenca e pretenduar si e uzurpuar të jetë e parashikuar në Kushtetutë. (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Për më tepër, Gjykata është ndalur në pozicionin kushtetues të Presidentit të Republikës, duke theksuar se: "Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës, në nenin 92 të Kushtetutës përcaktohen kompetencat e Presidentit të Republikës,.." (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese, prg. 34*).

4. Në çështjen në shqyrtim, Presidenti, në pozitën e kërkuesit para kësaj Gjykate, i përqendron pretendimet e tij në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së vet, pra të ushtrimit të kompetencës për emërimin e Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së, parashikuar nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë". Sipas tij, Kuvendi i ka mohuar të drejtën e propozimit të kandidaturave për postin e Inspektorit të Përgjithshëm, për shkak të krijimit të vakancës për këtë post. Gjithashtu ai ka pretenduar se me vendimin nr. 14/2014 të Kuvendit, balanca ka ndryshuar duke mos u respektuar parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve.

---

juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese. Votuan për zgjidhjen në themel të çështjes gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari.

5. Mendoj se ky pretendim i kërkuesit *prima facie* është kompetencë ligjore, por gjithsesi duhej analizuar nën dritën e përcaktimeve të nenit 94 të Kushtetutës, sipas së cilit: "Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen në ligje të nxjerra në pajtim me të". Në këndvështrimin tim, në kontekstin e çështjes konkrete, pra të së drejtës së Presidentit për propozimin e kandidaturave për Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKPKI-së në rast vakance ekziston një marrëdhënie kushtetuese e Presidentit të Republikës me Kuvendin për shkak të kësaj dispozite e cila duhej të ishte analizuar. Edhe pse me ligjin nr.45, datë 24.4.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", i është hequr kjo kompetencë Presidentit të Republikës, në momentin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, Presidenti e kishte këtë kompetencë prandaj dhe Gjykata duhet të ishte ndalur në mënyrë doktrinale dhe jurisprudenciale në raportin ndërinstitucional të marrëdhënies së Kuvendit me Presidentin e Republikës për rastin konkret.

6. Si përfundim, vlerësoj se Gjykata në funksion të rolit të saj si dhënëse e drejtësisë kushtetuese, garante e Kushtetutës dhe interpretuesja e fundit e saj, duhej të ndalej në interpretimin e përmbajtjes së neneve 92 dhe 94 të Kushtetutës dhe diferencat mes tyre në drejtim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Presidentit të Republikës, për rrjedhojë të konkludonte nëse konflikti ishte kushtetues dhe më pas nëse kishte apo jo mosmarrëveshje kompetence mes organeve të përfshira në konflikt. Në këtë këndvështrim, Gjykata duhet të analizonte në themel dhe t'i jepte përgjigje pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykim.

KRYETARI
Bashkim Dedja

MENDIM KUNDËR

1. Gjykata, në çështjen me kërkues Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis tij dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e vendimit nr. 14/2014, datë 20.2.2014, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave", bazuar në nenin 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", ka vendosur refuzimin e kërkesës, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm të votave për arritjen e një përfundimi.

2. Nisur nga kjo vendimmarrje, e paprecedent në jurisprudencën e kësaj Gjykate për kërkesa të kësaj natyre, mendoj se duhet të marrin përgjigje disa pyetje lidhur me arsyet që Gjykata nuk arriti të marrë një vendim në rastin konkret dhe për të cilat ndaj mendim të kundërt me një pjesë të gjyqtarëve.

A. Për konfliktin e interesit të gjyqtarit kushtetues

3. Sipas vlerësimit tim, arsyeja e parë që mundësoi ndarjen e votave në mënyrë të barabartë është sepse Gjykata nuk gjykoi çështjen objekt shqyrtimi në përbërje të plotë, për shkak të pranimit (nga Gjykata) të kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, për konflikt interesi, të gjyqtares A.Xh. Ndërkohë Gjykata, kërkesën e subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, për përjashtimin e gjyqtarit V.K. (po për konflikt interesi) e rrëzoi, duke marrë kështu një vendim me dy standarde.

4. Në këtë këndvështrim, çështja që vlen të diskutohet është nëse ndodhet në konflikt interesi gjyqtari kushtetues në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave apo të kontrollit të antikushtetutshmërisë së ligjeve?

5. Paanshmëria e gjyqtarëve është një nga parimet më të rëndësishme në një shtet të së drejtës, e cila passjell shmangien e konfliktit të interesit. Për këtë arsye nenet 36 dhe 37 të ligjit organik të kësaj Gjykate kanë parashikuar respektivisht rastet e heqjes dorë dhe të përjashtimit të gjyqtarit kushtetues. Sikurse është shprehur edhe Komisioni i Venecias[2], qëllimi i këtyre dispozitave nuk është mbrojtja e gjyqtarëve nga akuzat për anshmëri, por mbrojtja e legjitimitetit të Gjykatës si një organ i paanshëm.

6. Neni 133/2 i Kushtetutës parashikon se marrja e vendimit të Gjykatës kërkon shumicën e votave të gjithë anëtarëve të saj. Për pasojë, nëse përjashtimi i gjyqtarëve çon në mosarritjen e kuorumit të nevojshëm nga Gjykata, si ka ndodhur në rastin konkret, ajo "bllokohet" në shqyrtimin e kërkesave. Një bllokim i tillë institucional ka pasoja të rënda sepse nuk i lejon Gjykatës kryerjen e funksioneve të sanksionuara në Kushtetutë (zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave), gjë e cila bie në kundërshtim me nenin 124/2 të Kushtetutës. Sistemi i garancive kushtetuese të Gjykatës dhe i detyrimeve që burojnë nga qenia anëtar i saj, të parashikuar nga Kushtetuta

[2] Opinioni *amicus curiae* nr. 524/2009, datë 13.10.2009 mbi ligjin për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve në Shqipëri.

(nenet 126-128) dhe nga ligji organik është ndërtuar në mënyrë të tillë që të shmangë "bllokimin" e Gjykatës, me qëllim që t'ju japë zgjidhje në çdo rast çështjeve të shtruara para saj.

7. Zgjidhja e konflikteve të kompetencave midis pushteteve, si dhe çdo çështje tjetër që lidhet me mbrojtjen e Kushtetutës, nuk janë të lidhura me vlerësime diskrecionale apo të gjykimit personal në favor të interesave të individëve të caktuar, por janë çështje me interes publik që lidhen me funksionimin e shtetit të së drejtës. Në këto rrethana, qëllimi për të shmangur një situatë në të cilën Gjykata do të "bllokohej" nga kontrolli për çështje të tilla është superior ndaj çdo interesi tjetër të përfshirë[3].

8. Bazuar në sa më lart, jam i mendimit se në të tilla situata, në balancën mes vlerësimit të rëndësisë që ka paanshmëria e gjyqtarëve (kur ata çmojnë se ndodhen në konflikt interesi apo kur kërkohet përjashtimi i tyre) nga njëra anë dhe nevojës së funksionimit normal të Gjykatës nga ana tjetër, mbizotëron interesi publik, mbrojtja e Kushtetutës. Kjo është arsyeja që kjo Gjykatë, si organ garant i respektimit të Kushtetutës, duhet të mundësojë funksionimin e saj në përbërje të plotë. Ky është një detyrim kushtetues dhe, në asnjë rast, përmbushja ose jo e këtij detyrimi nuk mund t'i nënshtrohet vlerësimit subjektiv qoftë të Gjykatës apo të anëtarëve të veçantë të saj. Mundësia e ekzistencës së konfliktit të interesit të gjyqtarëve kushtetues, qoftë edhe në një rast hipotetik apo mosfunksionimi i saj në përbërje të plotë për shkaqe objektive (sëmundje, etj.)[4], nuk duhet të çojë në asnjë rast në pamundësinë e Gjykatës për të marrë një vendim përfundimtar. Në të kundërt, vendime të tilla, si në rastin në shqyrtim, mund të sjellin, në situata të caktuara, kriza institucionale që jo vetëm mund të venë në dyshim qenien e kësaj Gjykate, por mund të tronditin rëndë themelet e shtetit.

B. Për legjitimimin e kërkuesit dhe juridiksionin e Gjykatës

9. Presidenti i Republikës së Shqipërisë (Presidenti) pretendon se midis tij dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) është krijuar një konflikt kompetencash për shkak të emërimit, nga ana e këtij të fundit, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Pra, kërkuesi pretendon se është cenuar në kompetencat e tij nga nxjerrja e një akti konkret të subjektit të interesuar, vendimit nr. 12/2014 të Kuvendit. Sipas Presidentit, Kuvendi në momentin që ka vendosur "lirimin" nga detyra të Inspektores së Përgjithshme të ILDKPKI-së, znj. Zana Xhuka dhe me të njëjtin vendim ka zgjedhur në këtë detyrë z. Shkëlqim Ganaj, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ka shmangur Presidentin lidhur me të drejtën e tij për të propozuar kandidaturat për postin vakant.

10. Sipas nenit 131, shkronja "ç", të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Veç këtyre, në mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve mund të përfshihen edhe mosmarrëveshje të tjera, siç janë ato që mund të lindin midis organeve apo subjekteve që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të shprehur në njërin apo tjetrin pushtet, të tilla si Presidenti, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria ose organe të tjera kushtetuese.

11. Gjithashtu, neni 54/3 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", parashikon në mënyrë të shprehur se, për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, të përcaktuara nga neni 131, shkronja "ç" i Kushtetutës, kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të ligjit të sipërpërmendur, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

12. Në jurisprudencën e saj, fillimisht, Gjykata është shprehur se një mosmarrëveshje kompetence që i paraqitet për zgjidhje duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshirë në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësëpari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues *(shih vendimet nr. 20, datë 4.5.2007 dhe nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Sipas doktrinës kushtetuese, që të kemi konflikt kompetencash midis pushteteve duhet të përmbushen tre kritere:

---

[3] Opinioni i Komisionit të Venecias të lartpërmendur.

[4] Por edhe në këto raste jam i mendimit se i përket ligjvënësit të përcaktojë parimisht mënyrën sesi duhet të zgjidhet situata e konfliktit të interesit të gjyqtarit kushtetues, me qëllim që Gjykata të gjykojë në përbërje të plotë, për të evituar "bllokimin" e saj.

a) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme;

b) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin;

c) mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave.

14. Gjykata ka elaboruar më tej konceptin e mosmarrëveshjes së kompetencës duke theksuar se ajo mund të paraqitet në formën e konfliktit "*normativ*", kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit *"individual"*, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto.* Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimet nr. 48, datë 8.11.2011; nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, neni 94 i Kushtetutës parashikon se *"Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të"*. Ndërsa neni 14 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" pasi ka sanksionuar në dy paragrafët e parë rastet e mbarimit të mandatit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në paragrafin e tretë parashikonte se: *"Në rast se vendi i Inspektorit të Përgjithshëm mbetet vakant, Presidenti i Republikës, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit dy kandidatura për Inspektor të Përgjithshëm"*[5].

16. Kushtetutëbërësi, pasi ka parashikuar disa kompetenca të Presidentit (*shih nenin 92 të Kushtetutës*), në pamundësi për të përcaktuar në mënyrë shteruese gjithë kompetencat e institucioneve kushtetuese (të Presidentit në rastin konkret) dhe në mungesë të një ligji organik për Presidentin (i cili do të përmblidhte të gjitha kompetencat e tij) nëpërmjet delegimit, parashikon ushtrimin e kompetencave të tjera të tij të cilat shprehimisht i jepen nga ligji (i cili duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën)[6]. Kështu ndodh edhe me Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë, kompetencat e të cilëve rregullohen më hollësisht në ligje të veçanta. Kjo do to thotë se nuk mund të shkëputen ligjet nga Kushtetuta. Pikërisht për këtë arsye, kur ligjet bien ndesh me Kushtetutën kundërshtohen si antikushtetues. Si përfundim, vlerësoj se kompetencat që mund të passjellin konflikt kompetence janë jo vetëm ato të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligje të tjera që janë në pajtim me të, pasi në këto raste (të fundit) autorizimi buron nga vetë Kushtetuta.

17. Nga sa më sipër, si dhe nisur nga pretendimet e kërkuesit, mendoj se Presidenti, si një ndër subjektet e cenuara nga konflikti i kompetencave legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate[7]. Ky konflikt ka formën e një konflikti "individual" pasi Kuvendi ka nxjerrë një akt i cili është bërë shkak për mosmarrëveshjen e kompetencave ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit, prandaj çështja hyn në juridiksionin kushtetues.

18. Duke shkuar më tej, në këndvështrimin tim, legjitimimi i subjektit që paraqet kërkesën dhe çështja e juridiksionit të kësaj Gjykate, sipas nenit 31/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Shqipërisë", janë kompetenca të fazës seleksionuese (Kolegjit). Në momentin që çështja ka kaluar në seancë plenare, si në rastin konkret, duhet të shqyrtohet zgjidhja në themel e saj[8].

C. Për themelin e çështjes

19. Bazuar në përfundimet e mësipërme, jam i mendimit se Gjykata duhej të shprehej për themelin e çështjes në shqyrtim dhe në këtë drejtim, vlerësoj se një arsye tjetër që nuk lejoi arritjen e një përfundimi lidhur me themelin e

---

[5] Ky nen aktualisht është ndryshuar me ligjin nr. 45, datë 24.4.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", të ndryshuar".

[6] Në këtë drejtim janë zhvilluar edhe diskutimet në komisionin parlamentar për hartimin e projektkushtetutës, shih Debati Kushtetues, Shtëpia Botuese P.SH., Tiranë 2006, fq. 319 -360.

[7] Kjo Gjykatë edhe më parë ka legjitimuar Presidentin për t'iu drejtuar asaj për zgjidhje të mosmarrëveshjes së kompetencave (shih vendimin nr. 41, datë 19.7.2012).

[8] Votimi i njërit prej gjyqtarëve për mungesë juridiksioni të kësaj Gjykate, është arsyeja e dytë që Gjykata, gjatë procesit të votimit, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.

kërkesës, është votimi i tre gjyqtarëve për pushimin e saj. Kuvendi, me ligjin nr. 45, datë 24.4.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", të ndryshuar", ka modifikuar plotësisht pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 të lartpërmendur (Presidentit i është hequr kompetenca për të propozuar kandidaturat e Inspektorit të Përgjithshëm). Për këtë arsye disa gjyqtarë ishin të mendimit se çështja mbetet pa objekt, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.

20. Edhe këtë mjet të përdorur nga disa gjyqtarë, pushimin e gjykimit, sikurse jam shprehur edhe më parë (*shih mendimin e pakicës së vendimit nr. 23, datë 16.4.2014*) e gjej të sforcuar, të pa përshtatshëm dhe të pa vend për çështje të kësaj natyre.

21. Gjykata ka marrë në shqyrtim edhe më parë çështjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet pushteteve, sikurse u përmend më lart, duke e përqendruar zgjidhjen e mosmarrëveshjes në kuadër të një prej parimeve më të rëndësishme të shtetit të së drejtës, atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Gjykata në këto raste ka arritur në përfundimin se ndarja e pushteteve në thelbin e vet është ndarje kompetencash dhe secili prej organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme kërkon, veçmas tjetrit, të shfaqë vullnetin e pushtetit nëpërmjet nxjerrjes së aktit.

22. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, fuqinë detyruese të arsyetimit të tyre. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimet nr. 5 datë 7.2.2001 dhe nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të kësaj Gjykate, si dhe nga rëndësia e veçantë që merr parimi i ndarjes së pushteteve, për më tepër kur subjekte të mosmarrëveshjes janë organe të një roli primar (Presidenti dhe Kuvendi) jam i mendimit se marrja në shqyrtim e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave, edhe pse nuk do të kishte efekte të drejtpërdrejta në rastin konkret, në këndvështrim të standardeve kushtetuese, paraqet interes të veçantë publik që lidhet, veç të tjerash, edhe me rregullimin e disiplinës objekt shqyrtimi për të ardhmen ashtu edhe me konsolidimin e mëtejshëm të jurisprudencës së kësaj Gjykate në këtë aspekt.

24. Në këtë këndvështrim, në çështjen në shqyrtim, jam i mendimit se Gjykata detyrohej të analizonte në themel dhe t'i jepte përgjigje pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykim.

ANËTAR
Vladimir Kristo

MENDIM MBI SHQYRTIMIN NË THEMEL TË ÇËSHTJES

1. Duke qenë se në çështjen me kërkues Presidenti i Republikës kam votuar për zgjidhjen në themel të saj, në vijim po parashtroj arsyet e këtij qëndrimi.

2. Në çështjen konkrete, Presidenti, në pozitën e kërkuesit para kësaj Gjykate, i përqendron pretendimet e tij në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së vet, pra të ushtrimit të kompetencës për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", i ndryshuar. Sipas kërkuesit, mohimi nga Kuvendi i së drejtës së Presidentit që, me rastin e krijimit të vakancës në postin e Inspektorit të Përgjithshëm në ILDKPKI, të propozojë kandidaturat sipas procedurës të përcaktuar në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr. 9049/2003, ka krijuar një konflikt kompetencash me natyrë normative midis dy organeve kushtetuese, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

3. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, rastet kur Presidenti i Republikës, me cilësinë e kërkuesit, ka pretenduar se është cenuar në kompetencat e tij nga nxjerrja e një akti konkret (vendim me natyrë individuale) të Kuvendit të Shqipërisë (subjektit të interesuar), janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese se përbëjnë një ngërç institucional që vjen si rrjedhojë e kuptimit të ndryshëm të normave kushtetuese dhe pikërisht për këto arsye, Gjykata është ndalur së pari tek interpretimi i dispozitave kushtetuese edhe pse në objektin e kërkesës nuk evidentohej një pretendim i tillë *(shih vendimin nr. 41, datë 19.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

4. Jurisprudenca kushtetuese në lidhje me kontrollin kushtetues të mosmarrëveshjeve të kompetencave midis pushteteve është tashmë e konsoliduar si për sa i përket subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, natyrës së aktit objekt kundërshtimi, ashtu dhe kufijve të ushtrimit të kësaj kompetence nga Gjykata Kushtetuese.

5. Konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e të njëjtës kompetencë, ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence. Nisur nga ky qëndrim, mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy plane: njëri plan lidhet me rastin kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Një plan tjetër është rasti kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një apo disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër (*shih vendimin nr. 41, datë 19.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Po ashtu, në bazë të nenit 54/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (ligji 8577/2000), ndërmjet të tjerash, që të iniciohet një çështje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushteteve përpara kësaj Gjykate, kërkesa duhet të ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti.

7. Roli i Gjykatës Kushtetuese në këtë kategori konfliktesh është ai i përcaktimit se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij të zgjidhë çështjen konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë ose ligjshmërinë e aktit (*shih nenin 56 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Duke qenë se thelbi i pretendimeve të kërkuesit dhe prapësimeve të subjektit të interesuar lidhet ngushtësisht me kompetencat e Presidentit dhe natyrën e tyre, vlerësoj të ndalem paraprakisht në evolucionin e pozitës dhe rolit të Presidentit të Republikës, si dhe të funksioneve e kompetencave me të cilat ai është pajisur fillimisht nga ligjet për dispozitat kryesore kushtetuese dhe më pas nga ligji themelor i shtetit shqiptar.

9. Në qartësimin e kuptimit të parashikimeve kushtetuese herë pas here është vlerësuar e nevojshme referimi edhe në *travaux preparatoires* për hartimin e Kushtetutës, njohur ndryshe si "*Debati Kushtetues*". Hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e Presidentit si ai i arbitrit, moderatorit të pushteteve, të rregullatorit, i cili do të pajisej me kompetencën e nxjerrjes së dekreteve individuale, pasi ato normative e bënin shumë të fuqishëm.[9] Presidenti i Republikës u ideua si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave ashtu dhe në balancimin e pushteteve dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive. Po ashtu, aspirohej që Presidenti të mos përfaqësonte thjesht shumicën parlamentare, por një trupë zgjedhore më të gjerë. Ekspertët, gjithashtu, vlerësuan edhe nevojën për ta përshtatur institucionin e Presidentit me regjimin parlamentar dhe vendosjen e një qeverie më të përgjegjshme dhe më të fortë në themel të tij.[10]

10. Në lidhje me kompetencat e Presidentit, nga *travaux preparatoires* rezulton se teknika legjislative e ndjekur ishte e ndryshme nga ajo e ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese, i cili kompetencat i rendiste njëra pas tjetrës. Kushtetuta, në pjesën për Presidentin, përmend vetëm ato kompetenca që kanë të bëjnë me kreun e shtetit dhe që nuk mund të përmenden në krerë të tjerë. Pavarësisht natyrës neutrale, Presidenti do të kishte kompetenca të rëndësishme për sa i përket emërimit dhe shkarkimit të ministrave, si dhe të një pjese të drejtuesve të institucioneve qendrore.[11]

11. Kushtetuta aktuale parashikon në nenin 92 një listë jo shteruese kompetencash presidenciale. Në këtë përcaktim bazohem në përdorimin e lidhëzës "edhe" çfarë të lë të kuptosh se në tekstin kushtetues gjenden kompetenca të tjera, fakt ky lehtësisht i verifikueshëm nisur nga raportet që ka Presidenti me pushtetet e tjera. Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, karakterizohet nga elementë të tre pushteteve: legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Për këtë arsye ai ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore (*shih vendimin nr. 38, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Neni 94 përcakton se *Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.* Sipas prapësimeve të Kuvendit të Shqipërisë, formulimi i përdorur nga Kushtetuta në nenin 94 është me karakter mohues. Pra, Presidenti i Republikës ndalohet të ushtrojë funksione tej atyre që nuk i njihen shprehimisht me Kushtetutë. Po ashtu, në

---

[9] Shih Debati Kushtetues, vëllimi 2, Tiranë 2006, f. 425

[10] Ibid, vëllimi 1, f.319

[11] Ibid, fq.320

prapësime parashtrohet se kompetenca, të cilën Presidenti i Republikës pretendon se është cenuar dhe për të cilën ka iniciuar këtë gjykim, nuk është kompetencë kushtetuese, sepse në asnjë normë të Kushtetutës nuk parashikohet, as shprehimisht, por as në mënyrë të nënkuptuar, kompetenca e Presidentit për propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

13. Kuptimi dhe interpretimi që do i bëhej në të ardhmen nenit 94 ka qenë dilemë edhe për hartuesit e Kushtetutës, të cilët gjatë diskutimeve kanë shtruar pyetjen nëse dispozita kushtetuese mund të përbënte një precedent negativ për të ardhmen, sipas të cilit Kuvendi, me ligje të veçanta, mund t'i jepte ose t'i hiqte Presidentit kompetenca duke prishur karakterin, strukturën dhe mënyrën e funksionimit të pushteteve. 12 Hartuesit e Kushtetutës pranonin se Presidentit mund t'i jepen kompetenca të tjera përveç atyre që do të parashikonte Kushtetuta, por në çdo rast kjo kompetencë do të bazohej në Kushtetutë. Ajo çfarë është e dukshme nga debati mbi tekstin kushtetues ka të bëjë me përdorimin në mënyrë të vazhdueshme të termit "*kompetencë kushtetuese*" dhe në asnjë rast "*kompetencë ligjore*" dhe po ashtu, evidentimi i kriterit të zbërthimit të kompetencave në ligjet përkatëse që do të miratoheshin në të ardhmen. Thelbi i këtij parashikimi kushtetues, sipas hartuesve të Kushtetutës, ishte që Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca pa ligj.

14. Dilema e dekadave të mëparshme mbi kuptimin e nenit 94 të Kushtetutës është rishfaqur në trajtën e një mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve dhe si e tillë i takonte Gjykatës Kushtetuese ta zgjidhte atë dhe jo të vendoste refuzimin e kërkesës. Vlerësimet mbi mungesën e juridiksionit të kësaj Gjykate për ta shqyrtuar këtë çështje apo arsyetimet se kjo gjykatë nuk ka çështje për të shqyrtuar për shkak të shfuqizimit të normës që parashikon kompetencën presidenciale objekt diskutimi janë devijim nga misioni i dhënies së drejtësisë kushtetuese.

15. Gjykata Kushtetuese duhet ta kishte shqyrtuar në themel pretendimin thelbësor të kërkuesit në mënyrë që t'i jepte përgjigje disa nga çështjeve që shtrohen në këtë rast: "Cili është roli i Presidentit në një republikë parlamentare dhe çfarë nënkupton parashikimi kushtetues i nenit 86 sipas të cilit Presidenti i Republikës është Kryetari i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit? Cila është lidhja midis këtij parashikimi kushtetues dhe kompetencave presidenciale? A ka ndonjë pasojë për rendin kushtetues, kushtetutshmërinë, shtetin e së drejtës, demokracinë nëse i heqim apo i shtojmë Presidentit të Republikës kompetenca sipas vullnetit të politikës? A passjellin këto iniciativa prishje të ekuilibrave dhe për rrjedhojë tronditje të themeleve të shtetit të së drejtës? A mundet që natyra e marrëdhënieve midis pushteteve (kushtetuese ose jo) të jetë përcaktuese e ndarjes së kompetencave presidenciale në kushtetuese ose jo?

16. Edhe në rastin konkret, nëse i referohemi qëllimit të krijimit nga ligjvënësi të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive evidentohet se ky institucion është i një rëndësie të veçantë në kuadrin e përpjekjeve të përbashkëta për luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik përmes administrimit të deklarimit të pasurive, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi edhe për kategoritë e zyrtarëve të lartë shtetërorë. Dhënia e kompetencës për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm një pushteti asnjanës garanton gjithashtu neutralitetin e emërtesës dhe ushtrimin e funksionit jashtë çdo presioni nga pushteti legjislativ apo ekzekutiv.

17. Atribuimi i Presidentit të Republikës i kompetencës së garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve, mendoj se nuk ka qenë një zgjedhje e rastësishme e hartuesve të Kushtetutës, pasi kjo detyrë i shërben para së gjithash garantimit të parimit të ndarjes së pushteteve që qëndron në themel të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, edhe kompetenca e Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të disa institucioneve me rëndësi në arkitekturën shtetërore i shërben pikërisht sigurimit të këtyre ekuilibrave institucionale. Garantimi i ndarjes dhe balancimit midis pushteteve duhet të sigurohet nga secili prej tyre dhe, në rast se këto ekuilibra prishen i takon Gjykatës Kushtetuese të thotë fjalën e fundit, duke përmbushur misionin e respektimit të Kushtetutës.

18. Përfundimi i çështjes pa përgjigje për bazueshmërinë (ose jo) të pretendimeve të kërkuesit edhe më parë është kritikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut se përbën cenim të së drejtës për aksesit dhe të sigurisë juridike në gjykimin kushtetues. Në këtë kuptim, mendoj se pavarësisht nëse kemi të bëjmë me kontroll konkret ose abstrakt në përputhje me kompetencat e përcaktuara në nenin 131 të Kushtetutës, përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e kësaj praktike negative përbën një precedent të rrezikshëm për garantimin e kushtetutshmërisë.

ANËTARE
Vitore Tusha

[12] Ibid, fq.323